

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT	
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I TRANSPORTA	
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION	
Njësia Org. Org. jedinica Org. Unit	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.
01	7414
Nr. i Lajm. e Br. Stranica No. Pages	Data: Datum: Date:
02-527	11-07-19
PRISHTINË/A	



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS	
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE	
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Njësia Org. Org. jedinica	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.
KM-MIT	485/19
2+2T	Data: Datum: Date:
	11-07-19
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria Infrastrukturës dhe Transportit
Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
Ministry of Infrastructure and Transportation

Ministri Infrastrukturës dhe Transportit, në mbështetje të nenit 145 (paragrafit 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe neni 38 (paragrafi 3) të rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës të Kryeministrit dhe Ministrave (22.03.2011), Rregulloren nr. 26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës të Kryeministrit dhe Ministrave, nenit 84 dhe 131 të Ligjit nr. 05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazta Zyrtare Nr. 20/21 Qershor 2016), nenit 5 dhe 21 Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, Udhëzimin Administrativ 06/2016 për plotësimin e Udhëzimit Administrativ 09/2013 për Rrjetin e Linjave dhe Rendit të Udhëtimit të Transportit Ndërrurban të Udhëtarëve me Autobus, dhe rekomandimit të komisionit të caktuar me vendimin nr. 5517 të dt. 23.05.2019, nxjerr këtë:

VENDIM

Refuzohet ankesa nr. prot. 4514 të dt. 30.04.2019 e parashtruar nga operatori transportues "Arbeni Tours" Sh.p.k nga Ferizaj, ndaj vendimit nr. 4191 të dt. 23.04.2019 për refuzimin e kërkesës për marrjen e nisjes në relacionin Shtimje - Ferizaj, për nisjen në ora 08:50 me kthim në ora 09:30.

Arsyetim

Komisioni i emëruar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit, me vendimin nr. prot. 5517 të datës: 23.05.2019, pas shqyrtimit të ankesës nr. prot. 4514 të dt. 30.04.2019 e parashtruar nga operatori transportues "Arbeni Tours" Sh.p.k nga Ferizaj, ndaj vendimit nr. 4191 të dt. 23.04.2019 për refuzimin e kërkesës për marrjen e nisjes në relacionin Shtimje - Ferizaj, për nisjen në ora 08:50 me kthim në ora 09:30, dhe pas vlerësimit të dosjes të aplikimit, kushteve për aplikim në shpalljen publike dhe procesverbaleve të komisionit të caktuar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit me vendimin nr. prot. 2259/18 të datës 06.03.2019 për vlerësimin e aplikacionit, vlerësojmë se komisioni ka bërë vlerësim të drejtë të aplikacionit ashtu që operatori në fjalë nuk i ka plotësuar kushtet sipas pikës (3) të shpalljes publike nr. 1643 dt. 21.02.2019 dhe paragrafit (1) nën paragrafi 1.7 të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër - urban të udhëtarëve me autobus i cili kriter është dhënë edhe në shpjegimin për mënyrën e aplikimit në shpalljen publike nr.1643 dt. 21.02.2019, pasi që i njëjti në dosje të aplikimit ka prezantuar 1 (një) autobus të certifikuar ndërsa sipas evidencës në DTT të konstatuar

nga komisioni sipas vendimin nr. prot. 355/18 të datës 06.04.2018 për vlerësimin e aplikacionit i njëjti posedon 4 (katër) leje në transportin ndërkombëtar.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë vendimi është marrë si në dispozitiv dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj padi në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Parashtruesit të kërkesës;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Zyrës së Arkivit të MI -së.

